



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 198, Datë 21.07.2026

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “ASSA ENERGY SOLUTIONS” SH.P.K. PËR LICENCIM
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1641/16 prot., datë 16.07.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1641 prot., datë 20.05.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, me kapacitet të instaluar 10 MW.
- Në vijim të këtij aplikimi, bordi i ERE-s me vendimin nr. 159, datë 05.06.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 06.06.2026 dhe 08.06.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 06.07.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 1641/3 prot., datë 16.06.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e marrëveshjes dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur një përgjigje.
- Me shkresën nr. 1641/4 prot., datë 16.06.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e dokumentacionit/informacionit të munguar.
- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1641/5 prot., datë 01.07.2026, shoqëria ka depozituar një pjesë të informacionit/dokumentacionit të munguar të aplikimit dhe ka kërkuar

shtyrjen e afatit të plotësimit të dokumentacionit me 10 (dhjetë) ditë, duke bërë me dije se nuk ka qenë objektivisht e mundur që të përgatitet dhe depozitohet në kohë.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet pranimi i kërkesës së shoqërisë, me qëllim që t’i jepet mundësia të plotësojë dokumentacionin e munguar. Duke marrë në konsideratë kohën e nevojshme për zhvillimin e korrespondencës dhe shqyrtimin e dokumentacionit, vlerësohet që afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë në lidhje me kërkesën e shoqërisë “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, me kapacitet të instaluar 10 MW. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 10 (dhjetë) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit në lidhje me kërkesën e shoqërisë “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Shoqëria të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 10 (dhjetë) ditëve.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM

ANËTAR I BORDIT

Petra LIKA